

KONTRATE BINJAKEZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

Përmirësimi i statistikave strukturore të ndë marrjeve II

Komponenti nr 3.2.1 **Statistikat e Biznesit**

Mision i realizuar nga
Antanina Valiulienë, Statistikat e Lituanië dhe
Bronislava Kaminskienë,
15 – 19 Shtator, 2014

IPA 2012

Emri, adresa dhe emaili i autoreve

*Bronislava Kaminskienė
Eksperte e pavarur
Architektu 212-14
LT-01500, Vilnius
Lithuania
Tel: +370 5 263 0849
Email: bronislava.kaminskiene@gmail.com*

*Antanina Valiulienė
Statistics Lithuania
29 Gedimino Avenue
LT-01500, Vilnius
Lithuania
Tel: +370 5 236 4858
Email: antanina.valiuliene@stat.gov.lt*

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komete të përgjithshme.....	4
2. Vlerësimi dhe rezultatet.....	4
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	6
Aneksi 1. Termat e Referencës.....	8
Aneksi 2. Personat e takuar	12

Lista e shkurtesave

AD	Të dhëna administrative
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
TeR	Termat e referencës
SL	Statistikat e Lituanië
ASN	Anketa Strukturore e Ndermarrjeve
RB	Regjistri i bizneseve
LLK	Llogaritë Kombëtare

1. Komente të përgjithshme

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat e Kosovës'. Është mision, që i kushtohet statistikave të biznesit në kuadër të komponentit 3 të këtij projekti. Misioni kishte për qëllim të përqëndrohet më tej në reduktimin e kohës së prodhimit dhe përmirësimin e cilësisë së ASN-së.

Objektivat konkrete të misionit ishte:

Të konsultohen dhe të punohet me profesionistët e ASK-së për përmirësimin e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve në Kosovë.

Konsulentet (ekspertja nga Statistikat e Lituaniës dhe ekspertja e pavarur) dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përpunohen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Lituaniës.

2. Vlerësimi dhe rezultatet

Bazë e misionit ishin aktivitetet e përfshira në termat e referencës.

Përshkrimi dhe vlerësimi i situatës si bazë për paraqitjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve jepet në seksionin 3.

Çfarë është arritur gjatë misionit. Problemet, vonesat.

1. Diskutimi me pjesëmarrësit nga ASK lidhur me planin e realizimit të ASN-së

Plani për realizimin e ASN-së është përgatitur dhe dorëzuar tek ASK përpara misionit. Ky plan bazohet në modelin GSBPM, janë përshkruar veprimet dhe rezultatet e secilit nënproces, pozitat përgjegjëse si dhe afatet kohore. Gjatë misionit, u diskutua dhe miratua ky plan. U dakordua që të fillohet me implementimin e tij për vitin referues 2014. Ky plan paraqitet në aneksin 1. Gjithashtu u diskutua afati për përgatitjen e kornizës së mostrës. Për përmirësimin e afatit kohor, u propozua të bëhet mostra për vitin referues duke përdorur listen e ndërmarrjeve aktive me të dhënat e vitit të kaluar.

2. Vështrim mbi redaktimin dhe metodat e imputimit

Specialistët në ASK paraqitën gjendjen aktuale dhe problemet, që lidhem me redaktimin dhe imputimin. U prezantua përvoja në redaktimin primar dhe sekondar dhe metodat e imputimit, të përdorura në Statistikat e Lituaniës. Pas diskutimit, u propozua që intervistuesit fillimisht të bëjnë një rishikim vizuel të pyetësorëve. Në lidhje me këtë, u propozua që specialistët e ASK të përgatisin instruksionet për kontrollin vizuel të të dhënave dhe të trajtojnë intervistuesit për këtë. Për të përmirësuar afatet kohore, rekomandohet të futen të dhënat ashtu siç janë. Pastaj të aplikohet një komandë, bazuar në rregullat e përcaktuara paraprakisht, duke rezultuar me një listë të dhënash, që nuk përmbushin ato kritere/rregulla dhe që duhet të analizohen më tej. U cek që procedurat e redaktimit primar sigurojnë përmirësimin e afateve kohore dhe cilësisë së të dhënave preliminare për Llogaritë Kombëtare. Për të përgatitur rezultatet përfundimtare të ASN-së, të dhënat statistikore duhet të korrigjohen me të dhënat administrative dhe të aplikohen metodat e redaktimit në nivel makro. Specialistët e ASK duhet të vendosin për rregullat dhe metodat, që do të përdoren. Për të siguruar cilësinë e lartë të rezultateve të ASN-së, propozohet të bëhen analizat e krahasueshmërisë dhe koherencës.

3. Ushtrime praktike mbi përdorimin e metodave të redaktimit dhe të imputimit

Zakonisht për redaktimin dhe imputimin e të dhënave përdoren softverë të veçantë (SAS, R ose të tjerë). Nëse numri i të dhënave nuk është shumë i madh, mund të përdoret Excel. Para misionit është përgatitur një dosje në excel me lloje të ndryshme metodash redaktimi, e cila u përdor gjatë ushtrimeve praktike të redaktimit të të dhënave të ASK për vitin 2012. Është rekomandim, që specialistët e ASK të përcaktojnë rregullat dhe metodat, që mund të përdoren në të ardhmen. Për të siguruar cilësinë e lartë të rezultateve të ASN-së, analiza e krahasueshmërisë dhe koherencës duhet të bëhet me metoda shumëdimensionale dhe në përputhje me rekomandimet e Eurostat-it për kontrollin e cilësisë.

4. Diskutim dhe ushtrime mbi përdorimin e të dhënave administrative në ASN, në ASK dhe Statistikat e Lituanië

U diskutuan të gjitha burimet e mundshme të të dhënave administrative. Statistikat e Lituanië kanë përvojën e tyre në përdorimin e burimeve të ndryshme administrative duke ulur në këtë mënyrë ngarkesën e ndërmarrjeve, duke përmirësuar vlerësimin e vlerave të munguara dhe cilësinë e rezultateve. ASKka qasje tek shumë të dhëna administrative, përfshirë të dhënat nga deklaratat financiare vjetore. Këto të dhëna duhet të analizohen dhe të përdoren në prodhimin e statistikave të ASN-së. Në mënyrë që përdorimi i burimeve administrative të jetë sa më efektiv, është e dobishme të arrihet një marrëveshje për qasjen online tek të dhënat e administratës tatimore dhe të organizohet mbledhja e tyre në atë mënyrë që disa të dhëna të futen paraprakisht automatikisht në pyetësorët statistikorë.

5. Diskutim dhe ushtrime mbi implementimin e NACE rev 2 në statistikat e biznesit

U prezantua përvoja e Statistikave të Lituanië në kthimin prapa në vite për shndërrim nga NACE rev. 1.1 në NACE rev. 2. Në Statistikat e Lituanië rikalkulimi i të dhënave u bë duke përdorur të dhënat mikro ose makro. Seritë kohore të indikatorëve u kalkuluan hap pas hapi. Koeficientët u kalkuluan duke përdorur të dhënat nga anketa e dyfishtë. Gjatë misionit u analizua gjendja në ASK dhe u dakordua që indikatorët e statistikave të biznesit mund të rikalkulohen përmes koeficientëve, të cilët mund të nxirren duke përdorur të dhëna nga anketa e dyfishtë e 2013.

Të gjitha dokumentet dhe prezantimet lidhur me çështjet e diskutuara u janë prezantuar specialistëve në ASK.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

1. Për të përmirësuar përmbajtjen afateve kohore, rekomandohet të përgatitet korniza e mostrës në fund të vitit referues duke përdorur të dhënat në dispozicion në regjistrin e bizneseve (qarkullimi dhe numri i të punësuarve për vitin t-1).
2. Rekomandohet që, duke filluar nga viti 2014, ASN-ja të realizohet sipas planit të miratuar. Për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve të përcaktuara, një rekomandim mund të jetë sigurimi i kapaciteteve administrative – specialist për redaktimin e të dhënave, imputimin dhe analizimin dhe një specialist me orar të pjesshëm për të punuar me të dhëna administrative.
3. Kontrolli vizuel i pyetësorëve në letër mund të bëhet nga kompania, që bën intervistat. Specialistët në ASK duhet të përgatisin instruksionet dhe duhet të trajnohen intervistuesit.
4. Për përmirësimin e procesit të mbledhjes së të dhënave, një rekomandim do të ishte të fillohet të punohet në aplikimin e pyetësorëve elektronikë, organizimin e transferimit të të

dhënave nga administrate tatimore në pyetëtorët statistikorë me disa të dhëna paraprakisht të plotësuar.

5. Për të rritur shpejtësinë e futjes së të dhënave, rekomandohet të aplikohet modeli nga lart poshtë: kur futen të dhënat, duhet të përgatitet një listë me të dhëna, që duhen analizuar më tej.

6. Rekomandohet të implementohen metodat e redaktimit primar dhe sekondar dhe të imputimit. Specialistët e ASK duhet të vendosin për rregullat dhe metodat, që do të përdoren. Në mënyrë që të përmbahen afatet kohore dhe të sigurohet cilësia e të dhënave preliminare për Llogaritë Kombëtare, duhet të aplikohen procedurat e redaktimit primar. Për të siguruar cilësinë e lartë të rezultateve të ASN-së, të dhënat statistikore duhet të korrigjohen me të dhënat administrative dhe të bëhet analiza e krahasueshmërisë dhe koherencës.

7. Ka shumë indikatorë të përfshirë në pyetëtorin statistikor, ndërkohë që publikohen vetëm disa. Kjo mund të jetë një arsye për përgjigjen e ulët dhe numrin e lartë të vlerave të munguara. Rekomandohet të ofrohen më shumë indikatorë statistikorë për përdoruesit.

8. Propozohet të kalkuloohen indikatorët e SSN dhe pas disa vitesh analizimi të thellë, të fillohet me publikimin e tyre.

9. ASK ka qasje në një numër të dhënash administrative, përfshirë të dhënat nga deklaratat financiare. Rekomandohet të analizohen këto të dhëna dhe të vendoset një strategji për përdorimin e tyre në prodhimin e statistikave strukturore të ndërmarrjeve. Kjo strategji mund të realizohet gradualisht, hap pas hapi.

10. Me softver të veçantë mund të sigurohen procedurat automatike të menaxhimit të të dhënave. Propozohet të shikohen mundësitë e sigurimit të një pajisjeje të tillë.

11. Shndrimi në NACE rev. 2 mund të bëhet duke përdorur koeficientët e nxjerrë nga anketa e dyfishtë për vitin 2013.

Aneksi 1. Termat e referencës

Termat e Referencës:

Komponenti 3: Statistikat e Biznesit

Aktiviteti 3.2.1.1: Vazhdim i reduktimit të kohës së prodhimit dhe përmirësimi i cilësisë së ASN

Afatet kohore:

TeR –të gatshëm:	01 Shtator 2014
Fillimi /përfundimi i aktivitetit:	15-19 Shtator 2014
Raportimi:	26 Shtator 2014

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultati obligativ	Intervenimi	Pike referimi	Burime informacioni	Supozimet
Rezultati obligativ 3.2	ASN Reduktimi i kohës së prodhimit dhe përmirësimi i cilësisë së ASN-se	<ul style="list-style-type: none"> Raporti mbi misionin, ku përkrahjet puna e bere, ajo çfare duhet te behet nga ASK-ja para misioneve te tjera ne ASN, i publikuar ne web faqen e projektit 	<ul style="list-style-type: none"> Raportet tremujore të Binjakëzimit Raportet e misionit 	<ul style="list-style-type: none"> Kapacitet i mjaftueshëm i absorbimit Qasje në të dhënat administrative dhe të anketave Numër i vogël i stafit i involvuar në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes te misioneve

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: aktiviteti 3.2.1.1:

Konsultimi dhe bashkëpunimi me profesionistët e ASK-së për përmirësimin e ASN-së në Kosovë

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 3.2.1:

Raporti mbi misionin me rekomandimet se si të reduktohet ASN-ja nga 150 ditë në 113 ditë në vitin 2017. Raporti duhet gjithashtu të përmbajë veprimet e propozuara, që të ndërmerren nga ASK-ja para misionit të ardhshëm lidhur me këtë çështje.

Stafi i ASK-së:

Z. Ismail Sahiti, Shef i Divizionit, ismail.sahiti@rks-gov.net (udhëheqës i komponentit)

Z. Hysni Elshani, Shef i Sektorit, hysni.elshani@rks-gov.net

Z. Muhamet Kastrati, Specialist i TI-së, muhamet.kastrati@rks-gov.net

Znj. Valdete Navakazi, Zyrtare e Lartë për statistika afatshkurta, valdete.navakazi@rks-gov.net

Znj. Luljeta Krasniqi, Zyrtare e Lartë në ASN, luljeta.krasniqi@rks-gov.net

Z. Bekim Bojku, Zyrtar i lartë për statistika të energjisë, bekim.bojku@rks-gov.net

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombetare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertet e vendeve anëtare:

Znj. Bronislava Kaminskiene, Shefe e Divizionit të Metodologjisë dhe Cilësisë, Statistikat e Lituanisë, bronislava.kaminskiene@stat.gov.lt

Znj. Antanina Valiuliene, Shefe e Divizionit të Statistikave të Ndërmarrjeve, Statistikat e Lituanisë, Antanina.Valiuliene@stat.gov.lt

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Përshkrimi i prapavijës për aktivitetin

Ky është misioni idytë lidhur me reduktimin e kohës së prodhimit dhe përmirësimin e cilësisë së ASN-së. Në raportin mbi misionin e parë “Përmirësimi i statistikave strukturore të ndërmarrjeve I. Kaminskienë & Valiulienë” janë paraqitur disa rekomandime dhe një plan se çfarë duhet të bëhet gjatë këtij misioni të dytë.

1. Konsulentet propozojnë të përdoret versioni i vjetër i pyetësorit duke modifikuar disa kapituj dhe pasi të testohet, kurse me versionin e ri të fillohet për vitin e ardhshëm referues;
2. Resurset aktuale nuk sigurojnë prodhimin e të dhënave cilësore në aspektin e afatit kohor, saktësisë dhe krahasueshmërisë.
3. Llogaritë Kombetare kanë nevojë për të dhëna në një stad më të hershëm – mund të përgatiten të dhëna preliminare për nevojat e tyre ose ASN-ja duhet të organizohet sipas planit të propozuar.
4. Specialistët në ASK duhet të përgatisin instruksione për kontrollin vizuel të të dhënave dhe të trajnohen personat, që grumbullojnë të dhënat.
5. Futja e të dhënave në bazën e të dhënave duhet të fillojë në momentin që merren pyetësorët, por jo të pritët derisa të mblidhen/kompletohen të gjithë pyetësorët. Duhet të përdoren më shumë procedura të automatizuara për kontrollin, redaktimin dhe imputimin e të dhënave.
6. Një plan optimal për realizimin e anketës ndihmon në sigurimin e saktësisë së rezultateve për cdo nenproces. Procedurat e automatizuara për redaktim përmirësojnë aspektin e afateve kohore, pa humbje të cilësisë. Aplikimi i më shumë rregullave të redaktimit do të sigurojë saktësi dhe krahasueshmëri më të madhe të të dhënave.
7. Gjatë misionit të ardhshëm do të diskutohen metodat e imputimit

Aktivitetet e nevojshme si përgatitje për misionin e ardhshëm

Veprimi	Afati kohor	Personi përgjegjes
Plani i ASN-se i përdorur në ASK	14 Maj	ASK
Rregullat e redaktimit të perdorura në ASK	fundi i Majit	ASK
Plani i zgjeruar i ASN-së	deri në misionin e ardhshëm	SL

Përshkrimi i rregullave të redaktimit	deri në misionin e ardhshëm	SL
Misioni i ardhshëm	15-19 Shtator	ASK dhe SL

Aktivitetet, që do të ndërmerren si përgatitje përmisionin:

Lista e dokumenteve të nevojshme

- Përmirësimi i statistikave strukturore të ndërmarrjeve I. Kaminskienë & Valiulienë

Pas misionit pritet të përgatitet:

- Raporti mbi misionin – sipas modelit për raportim
- Një plan për aktivitetet e ardhshme në komponentin 3.2 në kuadër të programit të binjakëzimit

Aneksi 1. Programi, Shtator 2014

Dita	Vendi	Koha	Aktiviteti
1	ASK	09.00	Hyrje
		09:15	ASK: Vështrim mbi punën e bërë në ASN (përfshirë rekomandimet dhe arritjet) që nga misioni i kaluar
		10:30	Pushim për kafe
		11:00	Programi për javën
		12:00	Dreka
		13:15	Plani i realizimit të ASN
		14:30	Pushim për kafe
		15:00	Diskutimi i planit të propozuar
		16:00	Versioni final i planit të realizimit të ASN
2	ASK	09:00	Metodat e redaktimit dhe imputimit të të dhënave
		10:30	Pushim për kafe
		11:00	Metodat e redaktimit dhe imputimit në SL
		12:00	Dreka
		13:15	Ushtrime praktike lidhur me redaktimin dhe imputimin e të dhënave
		14.30	Pushim për kafe
		15:00-16.30	Rregullat e redaktimit për indikatorët e SSN
3	ASK	09:00	Përmbledhje e ushtrimeve praktike
		10:30	Pushim për kafe
		11:00	Përdorimi i të dhënave administrative për ASN në ASK
		12:00	Dreka
		13:15	Përdorimi i të dhënave administrative për ASN në SL
		14:30	Pushim për kafe
		15:00-16.30	Diskutim rreth përdorimit më të gjerë të të dhënave administrative në ASN nga ASK
4	ASK	09:00	Takime
		10:30	Pushim për kafe
		10:45	Dakordim rreth rekomandimeve dhe planit kohor

		12:00	Dreka
		15:00	Takim me udhëheqësin e projektit, të komponentit dhe RTA: Rekomandimet, plani kohor dhe aktivitetet për tu ndërmarrë nga ASK
5	ASK	09:00	Shkrimi i raportit
		10:30	Pushim për kafe
		10:00	Shkrimi i raportit
		12:00	Dreka

Aneksi 2. Personat e takuar

ASK:

Z. Hysni Elshani, Shef i Sektorit, hysni.elshani@rks-gov.net

Znj. Valdete Navakazi, Zyrtare e Lartë për statistika afatshkurta, valdete.navakazi@rks-gov.net

Znj. Luljeta Krasniqi, Zyrtare e Lartë në ASN, luljeta.krasniqi@rks-gov.net

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Perkthyesi (disa misione)